



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 2218/1 Prishtinë 15-09, 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti **Kushtrim Shabani** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: "Ndikimi i rregullsisë së **structures në analizen sizmike**" në programin e studimeve Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Gjatë një tërmeti, dështimi i strukturës fillon në pikat e dobëta të saj. Si pika të dobëta të një strukture mund të konsiderohen shpërndarja e parregullt e masës, ngurtësisë dhe gjeometria e strukturës. Strukturat që kanë këto dobësi konsiderohen si struktura të parregullta. Këto parregullsi të cekura më lartë janë disa nga arsyet kryesore të dështimeve të strukturave gjatë tërmeteve.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të kuptohet qartë rëndësia e rregullsisë së strukturës dhe shpërndarjes së mureve sizmike në planimetri. Këto parametra të lartëcekura dhe shumë parametra të tjerë të ndërlidhura me njëra tjetrën janë shtjelluar gjatë analizës sizmike për të dy objektet e shqyrtuara në veçanti.

Tek pjesa e parë e këtij punimi është shtjelluar pjesa teorike e cila ndërlidhet me pjesën e dytë në të cilën janë marrë dy shembuj konkret ku përmes tyre synohet që të eksplorohej analiza sizmike dhe krahasimi i rezultateve të dy ndërtesave me etazhitet P+6K, ku ndërtesa e parë konsiderohet si e rregullt kurse ndërtesa e dytë si e pa rregullt.

Analiza sizmike e të dy objekteve është kryer duke u bazuar në standardet europiane, gjegjësisht në eurokodin EN 1998-1:2004. Softueri inxhinierik që është përdorur për modelim dhe llogaritje të strukturave është ETABS.

Fjalët kyçe: rregullsia, struktura, ngurtësia, analiza, tërmeti.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimitarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimitarisë.